FATI I REVISTAVE KULTURORE "REAKSIONARE" PAS VENDOSJES SË DIKTATURËS NË SHQIPËRI

(*Çfarë i bënte "armiqësore" revistat kulturore të viteve '30-'40, ku shkruan Fishta, Koliqi, Merxhani, Poradeci etj.*)

Ma. Alma Mile

Çdo diktaturë mbahet në këmbë duke mbjellë frikë. Nënshtrim përmes represionit. Por nga ana tjetër, asnjë syresh nuk ka shpëtuar pa u prekur nga paranoja.

Diktatori sheh armiq kudo: te kundërshtarët politikë, te pronarët, tregtarët, artistët, deri te fëmijët e kampit famëkeq të Tepelenës, të dënuar për të vdekur në kushte çnjerëzore, tek oborri i tij, pse jo edhe brenda familjes. Por më të "rrezikshmit", ishin intelektualët.

Në vitet '30-'40, në Shqipëri filloi të krijohej një elitë intelektuale. Të shkolluarit në Perëndim apo në Stamboll, po ktheheshin dhe po sillnin eksperienca, duke tentuar të gjenin veten e tyre në një vend që po përpiqej të ngrihej në këmbë.

"Shqipnia u ba, tash duhen ba shqiptarët", thoshte At Gjergj Fishta. Dhe me këtë kishte parasysh ndriçimin e mendjeve të shqiptarëve përmes dijes. Gazetat dhe revistat u panë asokohe si një mjet për të realizuar këtë qëllim, për të përçuar ide përparimtare e demokratike, kulturë dhe një frymë europiane. E kështu nisi një periudhë e shkëlqyer e shtypit të shkruar.

Përgjatë afro një dekade gjalluan disa nga revistat më të rëndësishme në historinë e shtypit shqiptar, ku shkruan penat më të rëndësishme të kohës, poetë, shkrimtarë, përkthyes, filozofë e ideologë, të cilët ofruan një dritare kulture në Shqipërinë e prapambetur e analfabete të gjysmës së parë të shek. XX. "Hylli i Dritës", "LEKA", "Përpjekja shqiptare", "Illyria", "Shkëndija", "Kritika", "Revista letrare", "Minerva", etj., janë disa nga revistat, të cilat mblodhën rreth vetes personalitete si At Gjergj Fishta, Ernest Koliqi, Branko Merxhani, At Anton Harapi, Lasgush Poradeci, Nebil Çika, Nexhat Hakiu, Mitrush Kuteli, Arshi Pipa, Vedat Kokona, Migjeni, Ali Asllani, Vangjel Koça, Tajar Zavalani, etj. Në faqet e këtyre revistave u botua folklor, poezi, prozë të autorëve shqiptarë e kryevepra të letërsisë botërore, filozofi, ndërsa mori jetë debati mbi

letërsinë dhe kritikën letrare. Pas instalimit të diktaturës komuniste, ato, jo vetëm u mbyllën, por emri dhe kontributi i tyre u fshi nga tekstet dhe historitë e letërsisë shqipe apo historisë së mendimit shqiptar, edhe pse ishin një hallkë e rëndësishme në këtë zinxhir zhvillimi. Ato u konsideruan "vegla të shtresave reaksionare". Fati i tyre u lidh ngushtësisht me fatin e drejtuesve dhe autorëve që shkruan nëto. U shpallën "armiq të popullit", u dënuan në mungesë, u dënuan me burg, u pushkatuan ose u lanë nëharresë. Vepra e Fishtës u mohua pas vdekjes; Ernest Koliqi e Arshi Pipa, u larguan nga vendi për të mos u kthyer më, ndërsa vepra e tyre u ndalua; At Anton Harapi u pushkatua, Vinçenc Prennushi vdiq në burg, Aleksandër Sirdani vdiq nën torturë; Mitrush Kuteli, Nexhat Hakiu, Vedat Kokona u lanë në hije.

Mjaft të lexojmë se si trajtoheshin dhe cilësoheshin ato në tekstet mësimore dhe akademike të para viteve '90. Citoj:

> *"Në kundërshtim me idealet që mbrojti shtypi patriotik, demokratik e revolucionar i periudhës 1912-1939, ishin organet që përfaqësonin interest e feudo-borgjezisë, të regjimit antipopullor të Zogut, të klerit reaksionar, si dhe të imperializmit. U botuan atëherë shumë gazeta e revista, që u shërbyen synimeve politike antipopullore dhe antikombëtare, përhapën e mbrojtën pikëpamjet filozofike reaksionare dhe obskurantiste nga më të ndryshmet, u bënë tribuna të letrarëve konservatorë dhe dekadentë. Fill mbas shpalljes së pavarësisë, nën drejtimin e Gjergj Fishtës, nisi të dilte revista "Hylli i Dritës", organ i murgjve françeskanë të Shkodrës (1913-1944), që përfaqësonte reaksionin katolik dhe interesat politike të Austro-Hungarisë e pastaj të Italisë, siç do të bënte edhe gazeta "Posta e Shqypnisë"(1916-1917), e cila botohej prej trupave austro-hungarezë të pushtimit dhe drejtohej po nga Gjergj Fishta. Tendencat antikombëtare dhe reaksionare u theksuan e u bënë të larmishme pas konsolidimit të regjimit feudo-borgjes. Ato u pasqyruan në organe të ndryshme, bie fjala revista e jezuitëve të Shkodrës, "LEKA", e drejtuar nga një jezuit fashist Italian (1929-1944), revista "Zani i Naltë" (Tiranë 1923-1939), organ i klerit reaksionar mysliman; e përjavshmja letrare "Illyria" (1934-1936), që e nxorri një grup profashistësh e fashistësh me tradhtarin Ernest Koliqi në krye; "Përpjekja shqiptare" (Tiranë 1935-1939), që u jepte vent të veçantë doktrinave*

filozofike të imperializmit-si pozitivizmi, niçeizmi, frojdizmi etj.- dhe organe të ndryshme qendrore dhe krahinore"[1].

Por për të kuptuar se çfarë i bënte kaq armiqësore këto revista, duhet të kuptojmë se çfarë ishin ato. Kam përzgjedhur dy prej tyre, si përfaqësuese të dy grupimeve të mëdha intelektuale, asaj të Veriut dhe të Neoshqiptarizmës.

1.3.2 "HYLLI I DRITËS"

Votër kulture shqyptare

Drejtor: At Gjergj Fishta

At Benedikt Dema

Jetëgjatësia: 1913-1914; 1921-1924; 1930-1944, Shkodër

"Hylli i Dritës asht ma i pari që lajmëron agun, diellin që mbas pak do të shndrisin. Nji vit mbas shpalljes së Pamvarsisë së Shqipnisë Fretnit françeskan pagzuen të përkohshmen e tyne zâmadhe me ketë emën, mbasi shihnin dritë e bekueme që do të shndriste ma në fund edhe mbi Shqipninë e lirë".

Revista "Hylli i Dritës", një nga revistat më jetëgjata fetaro-kulturore, u themelua në Shkodër në vitin 1913 prej At Gjergj Fishtës. Numri i parë i revistës mban datën 1 tetor 1913 dhe u shtyp në shtypshkronjën "Nikaj".

"Hylli i Dritës" e zhvilloi jetën e vetë në tri periudha për shkak të mbylljeve dhe rihapjeve, të censurës apo edhe situatës së pafavorshme për shtypin shqiptar.

Periudha e parë përfshin një kohëzgjatje një vjeçare (1913-'14), dhe do të ishte më së shumti një periudhë sprove për drejtuesit e saj. Megjithëqë kuvendi françeskan nuk e kishte për të parën herë që botonte gazeta e revista, pas "Albanisë" së Konicës, e cila e bëri jetën e vet jashtë vendit,

[1]Historia e letërsisë shqiptare. Që nga fillimet deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Instituti I Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë 1983

ndoshta kjo ishte e para revistë me një karakter kaq të gjerë kulturor dhe civilizues. Që në numrat e parë do të trajtohen çështje që lidhen me formimin qytetar dhe atdhetar të shqiptarëve, aftësinë e tyre për të bërë shtet, pas 5 vjetësh pushtimi të huaj, çështje të marrëdhënieve mes lirisë dhe fesë, kombësisë dhe fesë, shoqërisë dhe shtetit, etj. E bashkë me to edhe shkrime të karakterit historik, kulturor dhe gjuhësor, e sidomos për këtë të fundit, gjuhën shqipe, e cila ende trajtohej si gjuhë dytësore në disa shkolla, pavarësisht se Shqipëria ishte tashmë një vend i pavarur. Sigurisht gjithçka trajtohej përmes këndvështrimit të doktrinës dhe moralit të krishterë. Por sado fetare dhe kulturore të ishte kjo revistë, nuk mund të qëndronte jashtë zhvillimeve të kohës. Kjo periudhë përkonte me një nga më të vështirat për Shqipërinë. Konferenca e Ambasadorëve në Londër, copëtimi i Shqipërisë, ardhja e Princ Vidit etj., ishin ngjarje, që nuk mund të qëndronin larg penës polemizuese të At Gjergj Fishtës. Kjo ishte një arsye boll e qartë dhe e mjaftueshme (sidomos pas botimit të "Nji komedi e pandershme e të shekullit XX") që përfaqësitë e fuqive të mëdha që gjendeshin në Shkodër të urdhëronin mbylljen e revistës[2].

Revista do të rihapej në vitin 1921, duke shënuar kështu periudhën e dytë të jetës së vet, deri në mbylljen e saj sërish në vitin 1924. Tashmë Shqipëria po ecte në rrugën e ndërtimit të shtetit dhe ishte me rëndësi propagandimi i mbrojtjes së këtij shteti të rilindur dhe krijimit të një ndërgjegjeje demokratike për shqiptarët. Çështje të edukimit, të arsimimit, të moralit të shëndoshë zunë vend gjerësisht në faqet e "Hyllit të Dritës". Ndërkohë që një vend i rëndësishëm i jepej edhe traditës sonë, folklorit. Në vitin 1924 ndodh Revolucioni i Qershorit, i drejtuar nga Fan S. Noli, Luigj Gurakuqi e Bajram Curri, që do të rrëzonin Ahmet Zogun me synimin e një shteti demokratik, çka rezultoi e dështuar dhe për 6 muaj, Zogu do të rikthehet në pushtet. Në këto kushte, revista detyrohet të pezullojë botimin.

Periudha e tretë (1930-1944), do të ishte edhe ajo më e shndritshmja në historinë e "Hyllit të dritës", duke e kthyer atë në një nga organet me të rëndësishme në lëmë të kulturës dhe të mendimit shqiptar. Ishte momenti që "Tash qi asht ba Sqypnija, duhen përba shqyptarët". Por kjo mund të bëhej vetëm me kulturë.

> "*E po Shqypnija- Atdheu i jonë i dashtun? Mjerisht duhet me thanë, se ene gjendemi në fund të shkallës së kulturës. Duhet me shkue s'dij sa pash poshtë nën dhe, për me hasë pa*

[2]Ëilli Kamsi, Hylli i Dritës 1913-1944. Bibliografí kronologjike, Botime Françeskane, Shkodër 2008.

hiri më ndonji thermi monumentit të kulturës së katragjyshave, të stërgjyshavet t'onë, sa s'gjen kund shej kulture shqiptare mbi dhe. Ndoi kishë e shkatrrueme, disa xhamia; që të gjithë monumentat e Shqypnis. E at herët me shka mund të mbaj uzdajë na se komi shqyptar mund do të ketë rruesë të gjatë e të lumnueshme? Secili popull ka tagër me jetue më vedi, po kje se asht i zoti me mbajtë vedin. Mirë po nji popull i pa kulturë në Evropë sod me sod nuk mund t'a mbajë vedin. Kultura i ban njerzt t'aftë për të kryem, detyrat ma së miri e për të mbaruem, në pak kohë e pa shum mund, punë të mëdha e të randa..."[3]

Tash që Shqipëria ishte në mes të një qerthulli idesh e rrymash, mes dëshirës për të ecur drejt Perëndimit, por me një të shkuar të gjatë si pjesë e një perandorie të Lindjes, në kohën kur bota ishte në prag të një lufte të re, kur idetë komuniste kishin përfshirë Europën dhe jo vetëm, Shqipëria, duhej të bahej, Shqipëria duhej të zgjidhte. "Prej kahë do të nisemi e ku do të kapemi!", shtronte pyetjen "Hylli i Dritës".

"Që me ditën e indipendencës s'onë, jeta shqiptare erdh e u zhvillue aq sa sod me siguri mund të thomi, se jetës primitive i asht prish viza, doket shqiptare gjenden në prakun e njij metamorfoze, e njajo kokme, brenda së cilës u mertis jeta shqiptare tash sa mot e vjet sod e çil, për me marrë nji trajtë të re qytetnimi, e cila do të jetë rilindja shqiptare. Na sod ndollim në kohën e tranzicjonit; prandej nuk ka se si vijon ma në gjejen statike jeta shqiptare, por, dashtë e pa dashtë, mirë a keq, tradicjonet, doket, pikëpamja e jetës komtare e përban karakterin e shqyptarit, tash e mbrapa do të përlahet prej rrymave e frymsimeve kulturave e botore të cillave ma nuk mund u hikin as s'mund u pështojm. Kahë e shohim kjartë e e prekim me dorë këtë fakt, me nji herë na tëfaqet pëvetje: kahë duem me i a mbajtë? Kahë duem me i dhanë jetës shqiptare?".

Dhe përgjigjen për këtë pyetje e jepte vetë redaksia, duke u ofruar lexuesve një gamë të gjerë shkrimesh me karakter studimor, historik, gjuhësor. "Hylli i dritës", do të qaste rreth vetes albanologë të shquar si Norbert Jokl, Georg Stadtmüller, etj. Qëmtimet folklorike do të ishin të përhershme në faqet e "Hyllit", aq sa edhe krijimtaria letrare. Vetë Gjergj Fishta do të botonte në faqet e saj, pjesë nga veprat e tij si "Lahuta e Malcis", "Mrizi i zanave", etj. Çështje të gjuhës dhe të letërsisë do të ishin parësore në revistë. Shkrimet që trajtonin probleme që lidheshin me

[3]Hylli I Dritës, nr.1, vjeta VI, 1930, Shkodër

gjuhën ishin të përhershme në revistë, madje ndodhte që t'i riktheheshin të njëjtës çështje edhe pas disa numrash apo edhe vitesh. Kështu, do të botoheshin në faqet e saj monografitë studimore "Për gjenezën e literaturës shqipe" të prof. Eqrem Çabejt, "Fjalori toponomastik" i Dom Nikollë Gazullit (pseudonimi Gelasius), "Gjurmime të nji moji në Romë" e "Dorëshkrime të Bibliotekës Nacionale të Parisit" të prof. Filip Fishtës, për të vijuar me të tjera kontribute nga Prof. Athanas Gegaj, At Gjon Shllaku, At Rrok Gurashi, etj.

Ndërkaq vijonin shkrimet polemizuese nga Fishta e At Anton Harapi, në çështje të ndriçimit të mendjes së shqiptarëve. Në kushtet e Luftës së Dytë Botërore, qëndrimi i tyre politik ishte i qartë: kundër bolshevizmit, por njëkohësisht edhe kundër nazizmit. Me pushtimin e Austrisë nga Gjermania fashiste, Gjon Kamsi do të shkruante "Austria ndërroi jetë". Pas vdekjes sëAt Fishtës që ishte themeluesi dhe drejtuesi i revistës, ajo u drejtua nga At Benedikt Dema, megjithatë në rëvistë mbeti e shkruar: "Themelue në vjetin 1913 nga At Gjergj Fishta".

Me ardhjen në pushtet të regjimit komunist, revista do të mbyllej, e bashkë me të do të vinte edhe persekutimi i klerit katolik shqiptar. Do të rihapej përsëri me nismën e françeskanit At Zef Pllumi, në vitin 1993, për t'u mbyllur në vitin e vështirë 1997. Në vitin 2006 "Hylli i Dritës" shënon hapjen e saj të pestë.

2.1 PËRPJEKJA SHQIPTARE"

Revistë e përmuajshme kulturale

Jetëgjatësia: 1936-1939, Tiranë

Drejtor-Pronar: Branko Merxhani

Rubrika: "Jeta dhe librat", "Libra të rinj", "Balkanologji", "Leksikografi", "Muaji ndërkombëtar", "Albanologji", etj.

Bashkëpunëtorë: Vangjel Koça, Lasgush Poradeci, Petro Marko, Et'hem Haxhiademi, Lumo Skëndo, Sotir Paparisto, Aleks Çaçi, Sotir Caci, Nexhat Hakiu, etj.

Në tetor të vitit 1936, në Tiranë do të dilte një nga revistat më të rëndësishme të përmuajshme kulturale. Nje revistë, si zgjatim i "Demokratisë" së Gjirokastrës, por e fokusuar më së shumti në lëmë të kulturës dhe filozofisë. Në numrin e parë, Branko Merxhani "Duke filluar nga puna", paraqet moton e famshme "Politikë s'ka, vetëm kulturë!". Teksa i njeh lexuesit me rrugën 5-vjeçare të "Demokratisë", revistën e çdo të shtune "Lëvizja mendore" dhe lëvizjen "Neoshqiptarisma", ndër të tjerat ai thotë:

> "*Në realitet ne sot nuk bëjmë gjë tjetër veçse të rifillojmë dhe të ndjekim një punë shkrimi dhe botimi, e cila formalisht për ne filloi qysh prej vitit 1928. Atë vi, atje poshtë në shkretëtirën e zezë, po çuditërisht tërheqëse të Gjirokastrës, në çapin e parë të punës bashkë me Vangjel Koçën, mikun tim me besë dhe të pandarë, por më pastaj, duke patur dhe miq të tjerë, të gjithë njerëz të mirë dhe të ndershmë, kishim vendosur edhe ne të nisim një përpjekje me karakter thjesht kultural. Të gjithë ishim po thua, krejt pa mjete. Shteti i Tiranës nuk çante kokën atëhere për lëvizjet kulturale ose mendore. Jo vetëm nuk çante kokën, por gjëja më e keqe ishte se frikësohej, dyshonte, shtypte dhe murmuriste"*.

Në "Qëllimi i revistës sonë", Merxhani shkruan:

> "*Neve nuk na mbetet një gjë për të bërë: Të botojmë revista! Të botojmë revista dhe të punojmë me mend, me system dhe me seriozitet. Të lemë mendjen t'onë të çliruar dhe t'emancipuar ndër idera të realitetit shoqëror shqiptar, të udhëtojë lirisht, por me ngadalë dhe me kujdes nëpër gërmadhat e jetës sonë Brenda të cilave flen qysh prej shekujsh…".*

Drejtuesit e kësaj reviste e kishin skemën e qartë, mbi të cilën do të funksiononte revista. Ata publikuan "Planin teknik" mbi rubrikat dhe prioritetet e revistës, që lidheshin së pari me kontributin në "organizmin e jetës kulturore shqiptare, sintetike nacionaliste", "formimin mendor të brezit të ri", "trajtime kritike e analitike rreth çështjeve aktuale kulturale të vendit", përkrahjen e "çdo talenti të ri letrar", duke botuar vjersha, trajtime letrare origjinale e përkthime "me kujdes e me durim".

Dhe që në numrin e parë botoi poezi të Lasgush Poradecit e Petro Markos, Et'hem Haxhiademit, etj.

"Përpjekja shqiptare" nuk synonte të ishte revista e të gjithëve. Ajo tentonte elitën shqiptare dhe se "*nuk është një revistë që u flet drejtpërdrejtë turmave. Është një revstë kulturale që ka si qëllim të vendosë dhe të rrahij probleme shoqërore të jetës sonë kombëtare, duke u përpjekur me sa është e mundur, të mbushë dhe të zëvendësojë mungesën fatale të një shkolle të lartë, një universiteti në këtë vend"*[4]. Dhe në këtë hulli është Lumo Skëndo që ngre pyetjen: "A kemi një elitë shqiptare dhe si ta krijojmë?"[5].

Në përputhje dhe me "planin teknik", në faqet e revistës do të gjenin vend rubrika si "Libra të rinj", "Jeta dhe librat", "Balkanologji", "Leksikografi", "Muaji ndërkombëtar", "Albanologji", etj. Do të botonin Poradeci, Petro Marko, Aleks Çaçi, Sotir Caci, Nexhat Hakiu, etj. Do të botoheshin përkthime nga Goethe, Alfred De Musset, Victor Hugo, etj. Po ashtu, "Përpjekja" nuk mund të qëndronte jashtë debateve mbi letërsinë, që gjallonte në të gjitha revistat kulturore të kohës. Mund të përmendim "Për një drejtim letrar" nga Dhimitër Shuteriqi, i cili përkrahte letërsinë moderne me përfaqësues Ernest Koliqin, teksa shtronte pyetjen se kujt mund t'i shërbenin më tragjedi klasike si ato që shkruante Ethem Haxhiademi… "Sot kemi nevojë për vepra me vlerë aktuale dhe jot ë përjetshme", shkruante ai[6].

Po një nga numrat më interesantë të "Përpjekjes" është ai kushtuar filozofit francez Descartes, botuar në gjuhën shqipe dhe frënge: "Descartes et nous"[7]. Ja sesi e motivon daljen e këtij numri redaksia e revistës: *"Une revue albanaise consacre a Descartes un numero special, cela pourrait sembler bizare pur un temps ou la vie albanaise ne presente aucune trace de vie et de mouvement philosophique"*. ("Një revistë shqiptare i kushton Dekartit një numër special, kjo mund të duket e habitshme, në një kohë kur në jetën shqiptare nuk shfaqet asnjë gjurmë jete e lëvizjeje filozofike") Më tej shpjegon për rolin që filozofia sidomos ajo karteziane ka në jetën sociale, politike, historike, në botën moderne. "*La periode actuelle de la vie albanaise a plus que jamais besoin de penser de raisonner, de faire disparetre les instincts non nobles et d'un activisme aveugle, qui në provient pas de la lumiere de la pensee et des sentiments nobles, mais du dilettantisme et passions personelles"- Redaction* ("Periudha aktuale e jetës shqiptare ka më shumë se kurrë nevojë të mendojë dhe të logjikojë, të zhdukë instiktet jo fisnike dhe një

[4] Përpjekja shqiptare, nr.2, Tiranë, nëntor 1936
[5] Po aty, Elita shqiptare-Detyra dhe përgjegjësija e sajë
[6] Po aty, maj 1937
[7]Përpjekja shqiptare, nr. 9-10, Tiranë, korrik-gusht 1937

aktivizëm sporadik, që nuk vijnë nga drita e mendimit dhe ndjenjave fisnike, por të diletantizmit dhe pasioneve personale".) (Redaksia)

Pavarësisht qëndrimeve politike të "Përpjekjes", e cila pati në radhët e veta përkrahës të fashizmit, revista u mbyll në vitin 1939.

Qëndrimi përballë fashizmit

Pavarësisht se përfaqësonin shkolla e kultura të ndryshme, "Hylli i Dritës" dhe "përpjekja shqiptare" kishin jo pak të përbashkëta. Krahas dëshirës për ndriçimin mendor, ato ishin qartazi antikomuniste, madje përballë dy "alternativave", asaj komuniste dhe fashiste, përfaqësues kryesorë të këtyre dy revistave përkrahën këtë të fundit.

Në rrafshin politik, "Përpjekja Shqiptare" e tha fjalën e vet përmes shkrimit të Branko Merxhanit "Pse nuk jam marksist"[8]:

> *"Unë jo vetëm se nuk jam anëtar i parimeve doktrinare të shkollës Marksiste, por jam edhe anti-komunist. Hem si njeri mendimtar, hem, dhe bile shumë më tepër, si njeri – shqiptar. Jo vetëm në lëmin e shkoqitjeve teorike, por edhe në pikëpamjet politiko-shoqërore të zhvillimit ndërkombëtar, unë nuk jam nga ata që pranojnë tezën se gjoja bota e qytetëruar e sotshme është ndarë në dy fronte ideologjike që luftojnë njëri-tjetrin gjer në pikën e fundit. Bota e sotshme, ashtu siç e shoh unë, është ndarë jo në dy, por në tri fronte ideologjike; pjesa e tretë, pjesa më e madhe, më e shëndoshë, më impozante, mbeti besnike ndaj parimeve të Demokracisë përparimtare dhe kapërcen me fuqi dhe me vullnet gjithë tronditjet dhe tërë nervozitetet që shkaktoi lufta ndërkombëtare e periodës 1914-1918 në struktura shoqërore të popujve të mëdhenj që morën pjesë në ndeshjen më të tmerrshme të gjithë historisë së njerëzimit. Dhe jam i bindur se popujt e qytetëruar, popujt e mbrumur dhe të rritur brenda një tradite të gjatë zhvillimi kultural, nuk mund t'i sakrifikojnë për hir të një aksidenti katastrofal, siç është çdo ndeshje luftarake. Liri të tyre të shtrenjta dhe të shenjta për fitimin e të cilave derdhën pjesën më fisnike të gjakut të tyre brez pas brezi botëra të tëra. Kjo është bindja ime e patundur".*

[8] Përpjekja shqiptare, nr.4, 5, 6,Tiranë, 1937

Jo rrallë herë, Perëndimi u identifikua me vendin fqinj, Italinë dhe shumë intelektualë e gjetën vetën më pranë fashizmit. Kështu ndodhi edhe me ithtarët e neoshqiptarizmës, që u atashuan pranë Partisë Fashiste, me pushtimin e Shqipërisë në 1939. Kështu, Vangjel Koça (1900- 1943), përkthyes i Epiktetit, Lukianit dhe Dekartit, gazetar dhe kritik letrar, i njohur në shtypin e kohës me pseudonimet Vangjo Nirvana apo Vangjo Krishna, do të bëhej udhëheqës i Partisë Fashiste pas pushtimit. Fundi i tij qe tragjik. U mbyt gjatë arratisë për në Itali më 7 gusht 1943. Ernest Koliqi pranoi detyrën e Ministrit të Arsimit, në qeverinë fashiste të Vërlacit, 1939-1941, ndërsa në 1942 zëvendëson Terenc Toçin në krye të Këshillit t'epërm korporativ fashist deri më 1943, vit në të cilin ai do të largohej nga Shqipëria në drejtim të Romës, ku do t'i kushtohej jetës albanologjike, botimit të revistës "Shejzat", por pa hequr dorë nga komunikimi me bashkëkombësit e tij në mërgim, për fatin e Shqipërisë, sidomos pas vendosjes së regjimit komunist. Po aq sa edhe qëndrimi i tij antikomunist edhe gjatë viteve të mërgimit në Itali, ku edhe vdiq në vitin 1975, ky angazhim politik, do t'i kushtonte rreth 50 vjet syrgjynosje letrare nga Shqipëria, si "tradhtar" dhe "bashkëpunëtor" me okupatorin, një fakt, që Koliqi e ka vuajtur shumë deri në fund të jetës së tij. Siç e kemi thënë edhe më lart, Koliqi do të njihej edhe në lëmë të editorisë. E përmuajshmja e tij letrare "Shkëndija", (korrik 1940-1943), që do të mblidhte rreth vetes emrat më në zë të kohës, letrarë e gjuhëtarë, do të bëhej revista më e madhe letrare gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Gjatë këtyre viteve kanë qenë jo pa rëndësi gazeta "Tomorri" e letrarja "Tomorri i vogël", pozicionuar qartësisht profashizmit, por falë punës së redaksisë së kulturës dhe përfshirjen e saj aktive në debatet e kohës, arriti të mblidhte rreth vetes emrat më në zë të krijimtarisë letrare dhe kritikës së atyre viteve. Tek "Tomori i vogël", që në krye të numrit të parë hapej me "parullën" "Me Duçen për Duçen", gjejmë sërish Poradecin, që siç do ta dëshmonte edhe shumë më vonë, nuk do të kishte fare lidhje me politikën, madje e injoronte atë, por edhe Nonda Bulkën, Sterjo Spassen, At Zef Valentinin, Vexhi Buharanë etj.

Kleri katolik po ashtu, u pozicionua qartazi kundër marksizmit dhe në mënyrë të natyrshme e pa veten pranë Italisë fashiste. Këtë qëndrim të sajin ajo e shprehu edhe në revistat përkatëse "Hylli i dritës" e "LEKA". Tek "Hylli i Dritës" gjejmë shkrime entuziaste për kalimin nën protektoratin e Italisë Fashiste. Këtë qëndrim proitalian e pranon tanimë edhe vetë kleri

katolik, por duke qartësuar pozitat prej nga buronte kjo mbështetje. Dr. Dom Nik Ukgjini në librin e tij studimor[9] mbi historinë e kishës katolike në Shqipëri shprehet:

> *"Kisha Katolike, kushtëzuar edhe nga nevojat e mëdha financiare, me ketë rast e përkrahu si partner të mundshëm, Italinë fashiste. Natyrshëm mbështeti më shumë pushtimin italian dhe lidhjet e ngushta që u krijuan me Italinë dhe Vatikanin, ku ky i fundit ishte i pafuqishëm t'i kundërvihej fashizmit dhe më vonë nazizmit gjerman. Kleri katolik nuk ishte i pakënaqur, duke qenë i vetëdijshëm se Shqipëria kishte nevojën e përkrahjes nga një shtet i fuqishëm. Dhe Italia katolike ishte protektori më i mirë, me kusht që të respektohej pavarësia. Imzot Gaspër Thaçi, Atë Gjergj Fishta, Atë Anton Harapi, Atë Pal Dodaj, Dom Lazër Shantoja, Ernest Koliqi, Mustafa Kruja etj., e kuptonin se në momentet e pushtimit, detyrë kryesore ishte ruajtja e pavarësisë së Shqipërisë, ruajtja e flamurit kombëtar, e shkollave dhe gjuhës shqipe, administratës shqiptare shtetërore, civile e ushtarake. Kleri katolik ishte nostalgjik ndaj pavarësisë së humbur, por ishte më i kënaqur me një autonomi të kufizuar për momentin, se sa me një Shqipëri të shkatërruar ekonomikisht e të qeverisur keq, siç ishte ajo e kohës të Mbretit Zog. Po të njëjtin mendim shprehte dhe delegati apostolik Leone Nigris, i cili më 28 maj 1939 do t'i shkruante Guvernatorit, Jacomonit, ku ndër të tjera kishte kërkuar disa garanci për të ardhmen e Shqipërisë si: respektimin e autonomisë, heqja dorë nga depërtimi i fashizmit në Shqipëri etj..".*

Komunizmi ishte për kishën katolike një e keqe e madhe, së cilës i duhej dalë para. Klerikë si Atë Gjon Shllaku, Dom Lek Sirdani, Dom Ndre Zadeja, Atë Mark Harapi, etj., shumica e të cilëve shkruan në faqet e "Hyllit të Dritës", të "LEKA"-s apo "Cirkës" si poetë, prozatorë, përkthyes, estetë e kritikë letrarë, paralajmëronin në fjalimet e tyre se "së shpejti do vijë një stuhi e zezë ateiste, e cila do shkatërroj mbarë Shqipërinë". At Anton Harapi, në një letër dërguar Arqipeshkvit të Shkodrës Gaspër Thaçit në vitin 1943, ndër të tjera shkruante: *"Nuk po mundem t'endem fort, pse komunistët po me ndjekin për gjurmë"*[10]. Përndjekja tashmë kishte filluar edhe pse Shqipëria ishte ende e pushtuar. Sipas Ukgjinit, qëndrimi i Kishës katolike ndaj komunizmit del shumë qartë që me rastin a ardhjes së gjermanëve në Shqipëri në tetor të vitit

[9]Dom Nikë Ukgjini, Kisha Katolike në trevat shqiptare (Nga shek. XI – Deri sot), "Gjergj Fishta", Lezhë, 2016
[10]Po aty

1943, kur Gaspër Thaçi, së bashku me klerin themeluan "Besëlidhja e Malësisë se Madhe", që përfshinte 13 bajrakë të Arqipeshkvisë së Shkodrës si kundërshtim ndaj depërtimit të partizanëve, deri me ardhjen e gjermanëve në ketë zonë. "Po kështu, kemi dhe angazhimin publik në Regjencën Gjermane të Atë Anton Arapit, të përkrahur nga bota françeskane dhe Dom Lazër Shantoja, Dom Ndre Zadeja, etj.. Harapi kërkonte unitet sa me të madh në popull, duke u shprehur: Nuk shpëton, jo, sot Xhamija pa Kishë, as Kisha pa Xhami, por as njena, as tjetra pa Shqipni", shton Ukgjini[11] .

Gjithashtu shumë prej emrat e klerikëve i gjejmë të renditur në formacionet politike të kohës.

> *"Në një relacion të Komitetit Qendror të vitit 1947 që mban titullin "Politika e Vatikanit në Shqipëri"…në Partinë Demokristiane dalin pothuajse emrat të gjithë klerikëve katolikë më në krye Delegatin Apostolik Leone Nigris; në Ballin dhe Legalitetin: Dom Zef Shestani, P. Luli, P. Anton Harapi, P. Gjon Shllaku, P. Daniel Dajani, Dom Ndre Zadeja etj."*.

Ky qëndrim do t'u kushtonte shtrenjtë, jo vetëm personaliteteve të sipërpërmendura, por gjithë klerit katolik në përgjithësi. Dëshmi është edhe lumturimi nga Papa Françesku i 38 martirëve të kishës katolike. Numër që në të vërtetë ishte shumë më i madh se 38. Kleri katolik u përndoq e u persekutua. Ishin me dhjetëra ata që provuan burgjet komuniste dhe torturat më çnjerëzore. Shumë u dënuan me vdekje, mes të cilëve At Anton Harapi, At Giovani Fausti, At Daniel Dajani, françeskani Gjon Shllaku, Dom Lazër Shantoja, Dom Aleksandër Sirdani, At Bernardin Palaj, e shumë e shumë të tjerë. Sipas studiuesit Dr. Dom Nikë Ukgjini, sipas një statistike mësohet se gjatë periudhës (1945-1980), që kur regjimi komunist dominonte, kishin vdekur nëpër burgjet e shtetit 2 argjipeshkëv, 5 ipeshkëv, 1 abat, 65 priftërinj dioqezanë, 33 françeskanë, 14 jezuitë, 10 seminaristë dhe 8 murgesha. Gjithsej 136 persona. Ndërsa ata që tashmë kishin vdekur, u dënuan me 'persekutimin', ndalimin e veprës së tyre, si në rastin e epikut të madh, At Gjergj Fishtës.

Kontributi në lëmë të letërsisë dhe ruajtjes së trashëgimisë shpirtërore, vlente më shumë se qëndrimet personale politike.

[11]Dom Nikë Ukgjini, Kisha Katolike në trevat shqiptare (Nga shek. XI – Deri sot), "Gjergj Fishta", Lezhë, 2016

Nëse shtypi letrari viteve ’30-’40 do të shfletohej, do të përdorej si material referent në studime, do të kuptohej se “viti zero” nuk fillonte në vitin 1944, se në Shqipëri kishte pasur një elitë intelektuale, se kishte pasur përplasje mendimesh dhe debate.

Por, ndriçim mendor dhe ofrimi i alternativave, ishte zmbrapsja e frikës dhe pa frikë, diktatura nuk do të dinte të jetonte, ndaj edhe shpallën armik këdo që tentonte ta bënte këtë.

Bibliografi

Historia e letërsisë shqiptare. Që nga fillimet deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 1983

Willi Kamsi, Hylli i Dritës 1913-1944. Bibliografí kronologjike, Botime Françeskane, Shkodër, 2008

Hylli i Dritës, 1930-1944, Shkodër

Përpjekja shqiptare, 1936-1939, Tiranë

Dom Nikë Ukgjini, Kisha Katolike në trevat shqiptare (Nga shek. XI – Deri sot), “Gjergj Fishta”, Lezhë, 2016